



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË**

Drejtoria e Privatizimit të Ndërmarrjeve dhe Shoqërive të Vogla dhe të Mesme

URDHËR
Nr. 294 Datë 4-8 2003

**PËR
PRISHJEN E SHOQËRISË ANONIME "HOTEL ARBANA" SH.A TIRANË**

Drejtuar: **Shoqëri Anonime "Hotel Arbana" Sh.a. Tiranë
Ministrise se Rregullimit te Territorit dhe Turizmit**

Me porosi te Keshillit te Ministrave per kalimin e ambjenteve (kryesore dhe ndihmese) te shoqërie anonime "Hotel Arbana" Sh.A. Tirane ne pergjegjesi administrative te Drejtorise se Pergjithshme te Policise se Shtetit,

KONSTATOVA

Se në mbështetje të nenit 1 të Ligjit nr. 8885, datë 22/04/2002 "Për disa ndryshime në ligjin Nr. 7926, datë 20/04/1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare, ndryshuar me akte të tjera ligjore"; të Ligjit nr. 7638, datë 19/11/1992 "Për shoqëritë tregtare" nenet 189, 263 e vijues; për shkak të motivit të mesiperm duhet që Shoqëria të fillojë procedurat e likuidimit.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, me cilësinë e zotëruesit të aksioneve të shoqërisë,

URDHËROJ:

1. Prishjen në rrugë gjyqësore të Shoqërisë "Hotel Arbana" Sh.A, Tiranë e regjistruar si person juridik me Vendimin nr. 24719, datë 27/12/2000 të Gjykatës së Rrethit Tiranë.
2. Caktimin si likuidator të Shoqërisë Z. Ramiz Dizdari me pagë mujore 30.000 lekë
3. Të hartohet dokumentacioni në përputhje me dispozitat e Seksionit të V të Ligjit Nr. 7638, datë 19/11/1992 "Për shoqëritë tregtare".

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.



Arben MALAJ
MINISTËR



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË
Drejtoria e Privatizimit të Ndërmarrjeve dhe Shoqërive të Vogla dhe të Mesme

URDHËR
Nr. 294/1 ___ Datë 29/10/2003

PËR
NJE NDRYSHIM NE URDHERIN NR 294 DATE 4.08.2003 "PER PRISHJEN E SHOQËRISË ANONIME "HOTEL ARBANA" SH.A TIRANË

Drejtuar: **Shoqëri Anonime "Hotel Arbana" Sh.a. Tiranë**
Ministrise se Rregullimit te Territorit dhe Turizmit

Nisur nga fakti se Keshilli Mbikqyres i shoqëri "Hotel Arbana", Tirane, me vendimin e tij nr.2 date 23.10.2003, ka liruar nga detyra drejtorin aktual Ramiz Dizdarin , i cili eshte caktuar likujdator me urdherin nr 294 date 4.8.2003.

Ne keto rrethana, në mbështetje të nenit 1 të Ligjit nr. 8885, datë 22/04/2002 "Për disa ndryshime në ligjin Nr. 7926, datë 20/04/1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare, ndryshuar me akte të tjera ligjore"; të Ligjit nr. 7638, datë 19/11/1992 "Për shoqëritë tregtare" nenet 189, 263 e vijues; duhet bere ndryshimi ne caktimn e likujdatorit.


PER KETO ARESYE:

Ne mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, me cilësinë e zotëruesit të aksioneve të shoqërisë,

URDHËROJ:

1. Shfuqizimin e pikes 2 te urdherit nr. 294 date 4.08.2003.
2. Caktimin si likujdatore të kesaj shoqërie Znj. Engjellushe Dizdari, me pagë mujore 30.000 lekë
3. Ngarkohet Drejtoria Juridike ne Ministrine se Ekonomise te ndjeke depozitimn e ketij ndryshimi ne vijim te urdherit nr. 294, date 04.08.2003 ne Gjykatën e Shkalles se Pare Tirane.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.





REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E EKONOMISE, TREGTISE DHE ENERGJETIKES
DREJTORIA E PERGJITHSHME E SHERBIMEVE TREGTARE
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TE PRONES PUBLIKE

URDHËR

Nr. 64 Date 27.01.2009

PER

MBYLLJEN E LIKUIDIMIT TE SHA. "HOTEL ARBANA"

TIRANE.

Ne mbeshetje te nenit 102 pika 4 te Kushtetutes, Ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe udhezimit nr 548 date 02.08.2007 te METE-s "Per shoqerite anonime ne likuidim e sipër me kapital teresisht shtetëror",

URDIHEROJ :

1. Mbylljen e likuidimit te sha "Hotel Arbana" Tirane.
2. I logaria "Kerkesa per arketim" e provizionuar dhe e parashkruar, te mbyllet dhe sistemohet me llogarine "Shpenzime" te likuidimit.
3. I logaria "Furnitore" e trashëguar nga Ndermarrje shtetërore dhe e pakerkueshme, te mbyllet dhe sistemohet me llogarine "Te ardhura te likuidimit".
4. Inventari i zyrave te kaloje ne administrim te sha "Shlepia Botuese Naim Frasheri" shoqeri ne likuidim.
5. Mardheniet financiare nderpriten ne momentin e depozitimit te urdherit te METE-s ne QKR.
6. Likuiditetet e mbetura te kalojne ne llogarine e buxhetit te METE-s.

Ky Urdhër hyn ne fuqi menjëherë.

MINISTRI

GENC RULLI

